



Në bazë të Qarkores buxhetore 2025/02, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019 , Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2024, me 14 vota "për" dhe 9 "kundër", merr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BUXHETIT PËR VITET 2025-2027

I.

Aprovohet buxheti i Komunës së Deçanit për vitet 2025-2027, sipas Qarkores buxhetore 2025/02.

II.

Buxheti për vitin fiskal 2025, 2026 dhe 2027, paraqitur si në tabelën në vazhdim:

	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
G. Përgjithshëm	6,723,132.00	7,111,603.00	7,507,160.00
G.S.Arsimi	4,825,149.00	4,969,903.00	5,119,000.00
G.S.SHëndetësisë	1,753,083.00	1,836,530.00	1,923,948.00
SH.REZIDENCALE	200,000.00	200,000.00	200,000.00
TOTAL GRANTI	13,501,364.00	14,118,036.00	14,750,108.00
T HV	900,571.00	978,279.00	1,056,666.00
TOTAL BUXHETI	14,401,935.00	15,096,315.00	15,806,774.00

III.

Të hyrat vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 autorizohen të shpenzohen në vitin 2025, për destinimet për të cilat është bërë zotimi i tyre.

IV.

Të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore të paraqitura në pjesën tabelore të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi, autorizohen për vitin fiskal 2025, për vitin fiskal 2026 dhe për vitin fiskal 2027, për periudhën prej 01 Janar deri me 31 Dhjetor të vitit përkatës.

V.

Nuk mund të bëhen kurrfarë shpenzimesh apo detyrime financiare të cilat bijën ndesh me këtë vendim.

VI.

Mjetet e destinuar për paga dhe shtesa nuk mund të tejkalohen, e gjithashtu as numri i punëtorëve të paraparë nga BKK.

VII.

Pjesa tabelore e paraqitur në ANEXIN PCF-1, PCF-2, PCF-3 dhe PCF-4 dhe tabelat e projekteve kapitale si dhe PIP-at e të gjitha linjave buxhetore janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

VIII.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IX.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti i buxheteve Komunale dhe organet kompetente të Komunës së Deçanit.

01.Nr.VIII-2

Deçan, dt. 26.09.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



KOMUNA DEÇANI	
KRYESUESI I KUVENDIT	
KODI POSTAL: 11000 DEÇAN	
Emri i Komunitetit:	KK. DEÇANI
Emri i Kryesuesit:	OA
Numri i Dokumentit:	33329
Data e Dokumentit:	27.09.24



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja **d**) lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 37 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera Nr.04/L-027("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.22/2011), Neni 12, neni 15, neni 29 dhe neni 31 paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, neni 26 pika 7. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSITË NATYRORE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Raporti i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në territorin e Komunës së Deçanit, gjatë vitit 2024, i hartuar nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të gjitha fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Raporti për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në territorin e Komunës së Deçanit, gjatë vitit 2024, i dt.17.09.2024, me Nr. të protokollit 02-32245.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e kryetarit të Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për BPPZHR e Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: MAPL, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për BPPZHR, Zyrës për Informim dhe Arkivit të Komunës.

01.Nr.VIII-5

Deçan,dt.26.09.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	NUMRI I DOKUMENTIT K. K. DEÇANI AS 33958
	DATA 01 03.10.24

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Duke u bazuar në Nenin 11, Nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja c), Nenin 17 shkronja c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/2019), Nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 26 pika 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR MË PAK SE NJË (1) VIT

Neni 1

Aprovohet Rregullorja për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit, për Komunën e Deçanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullorja për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit, për Komunën e Deçanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike e komunës së Deçanit.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Shërbime Publike, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arhivit.

01.Nr.VIII-6

Deçan,dt.26.09.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:
Hajdar SUTAJ



Në bazë të Nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2018 për planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit 26 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019 Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT- STRATEGJISË KOMUNALE PËR
MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027)
DHE
PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024 – 2027)

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për vënien në Konsultim Publik të Draft- Strategjisë Komunale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 – 2027) dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2024 – 2027).

II.

Diskutimi publik zgjatë 30 ditë, përkatësisht prej datës 04.10.2024 deri me datën 04.11.2024, brenda së cilës Zyra e Kryetarit në koordinim me Zyrën për Barazi Gjinore dhe Zyrën për Informim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme me palët e interesuara për këtë Draft-Strategji, ndërsa Debati i përgjithshëm publik me qytetarë do të mbahet me dt.01.11.2024, duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit kati i I-rë në objektin e Komunës.

III.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet dhe komentet mund të drejtohen në Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën për Barazi Gjinore ose në Zyrën për Informim.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra për Barazi Gjinore dhe Zyra për Informim të Komunës së Deçanit.


V.

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.VIII-7

Deçan,dt.26.09.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



[Handwritten signature]